



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3263 / Prot. 1

Tiranë, më 9.5. 2022

URDHËR

Nr. 248, datë 9.5 2022

PËR
NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR PARANDALIMIN, KONTROLLIN
DHE ZGJIDHJEN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve civilë”, të ndryshuar, si dhe të urdhrit nr. 144, datë 16.12.2021, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës, për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me përbërjen, si më poshtë:
 - a) Z. Nebi Ganellari, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Sistemit Ministror.
 - b) Znj. Anastasi Shakaj, me detyrë Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Aparatit të Ministrisë.
 - c) Z. Novruz Ahmeti, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Aparatit të Ministrisë.
2. Njësia e ngritur në pikën 1 të këtij Urdhri do të mbajë në vijimësi kontaktet me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
3. Urdhri nr. 58, datë 09.02.2017, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave, për vitin 2017”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm dhe Autoriteti Përgjegjës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI



Konceptoi: N. Ahmeti 12.4.2022
Miratoi: A. Çelaj2022
Konfirmoi: A. Kushi2022

